

Fillimi > -Kronikë

Trafikonin kapsolla elektrodetonatore, arrestohen 3 të rinj në Durrës, policia jep detajet

15 Mars, 2022 09:19



Madhësia e tekstit: - +

- Tre persona kanë rënë në pranga pasi u kapën duke shitur kapsolla elektrodetonatore.
- Në pranga kanë rënë A. Q., 32 vjeç, lindur dhe banues në Përmet; Xh. V., 22 vjeç, i dënuar më parë dhe L. B., 18 vjeçe, të dy banues në Durrës.
- Uniformat blu bëjnë me dije se gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 2000 kapsolla elektrodetonatore dhe se gjatë kontrollit fizik 22-vjeçarit Xh.V., i është gjetur dhe sekuestruar edhe një thikë.

Durrës-Informacion

Finalizohet operacioni policor i koduar “Ditë Vere”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e trafikimit të armëve dhe municioneve luftarake.

Operacioni nga Seksioni për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve në DVP Durrës.

Sekuestrohen 2000 kapsolla elektrodetonatore.

Arrestohen në flagrancë 3 shtetas, në momentin e shitjes së kapsollave.

Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e trafikimit të armëve dhe municioneve luftarake, bazuar në informacionet e marra në rrugë operative, nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve është organizuar dhe finalizuar operacioni policor i koduar “Ditë Vere”, në kuadër të të cilit u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:

-A.Q., 32 vjeç, lindur dhe banues në Përmet;

Xh. V., 22 vjeç, i dënuar më parë dhe L. B., 18 vjeçe, të dy banues në Durrës.

Këta shtetas janë kapur në flagrancë nga shërbimet e Policisë, te Shkëmbi i Kavajës, në momentin e shitjes së kapsollave elektrodetonatore.

Shtetasi Xh. V. dhe shtetasja L. D. po qarkullonin me një automjet tip “Audi”, me të cilin kanë shkuar te Shkëmbi i Kavajës, ku i priste shtetasi A. Q., i cili kishte ardhur nga Përmeti dhe kishte me vete një çantë krahu dhe një kuti kartoni brenda të cilave kishte pako me kapsolla elektrodetonatore (gjithsej 2000 copë). Në momentin e shkëmbimit të kapsollave, këta shtetas janë kapur në flagrancë nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafikeve të Paligjshme dhe Narkotikëve.

Gjatë kontrollit fizik, shtetasit Xh. V. i është gjetur një thikë.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 2000 kapsolla elektrodetonatore, një xhakëtë dhe një pulovër si ato të Policisë (me simbole të Policisë), një kapuç, një thikë, automjeti tip “Audi” dhe 4 aparate celulare.

Në bashkëpunim me Prokurorinë vijon puna për zbardhjen e plotë të këtij rasti.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për hetime të mëtejshme, për veprat penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”, “Mbajtja pa të drejtë e uniformës” dhe “Trafikimi i armëve dhe i municionit”.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: Durrës kapsolla

TË NGJASHME



Aksident në Durrës, makina del nga rruga dhe përplaslet me trafikndarësen, plagoset pasagjerja

15 Mars, 2022



Protesta në Durrës kundër rritjes së çmimeve, lironen në sallën e gjyqit dy të ndaluar

15 Mars, 2022



"Lekët për Malumën, si floriri i këtij abazhuri"/ Muzika ndërpret bashkëbisedimin e Ramës: Nuk po e dëgjojmë me lekët e taksave, mos më... "Lekët për Malumën, si floriri i këtij abazhuri"/ Muzika ndërpret bashkëbisedimin e Ramës: Nuk po e dëgjojmë me lekët e taksave, mos më thoni ul çmimet o njeri...

balkanweb.com


Shfaq Komente (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




Ishte menaxher në kompaninë "Bana King" ku u zbulua kokaina që vinte nga Ekuadori, Apeli rikthehen sërish në burg Marson Murataj

15 Mars, 2022



Dy vëllezërit tentuan ta vrisnin, flet 45-vjeçari: Si më qëlluan me thikë, nga konflikti për makinën e shitur, tek sherri për vendin e parkimit të taksisë

15 Mars, 2022



"Rrugorja" në aksion, arrestohen 20 drejtues automjesh dhe pezullohen 117 leje drejtimi, policia jep detajet

15 Mars, 2022




Vidhnin banesa dhe biznese në Kamzë, 3 të rinj në pranga

15 Mars, 2022



Tentuan të vrisnin me thikë 45-vjeçarën në Tiranë, vihen në pranga dy vëllezër (EMRAT)

15 Mars, 2022



Kanabis, armë dhe drejtim mjeti në gjendje të dehur/ Arrestohen 4 persona në Tiranë për vepra të ndryshme penale


15 Mars, 2022

KATEGORIA VIDEO



"Alumni talk", nisma e re e Universitetit "Luigj Ure" do të jetë bashkëbisedim me një ish-student, rikthen në autor Oriela Nebiain

15 Mars, 2022




A duhet bashkim i PD kur Berisha njih vetëm votën e lirë, Tabaku flet për herë të parë pas 6 marsit: Kundërshtari ynë i vetëm është...

15 Mars, 2022



"Çmimi i energjisë për bizneset është rritur", Tabaku: Bordi, shpikje allakomunizëm! Masat e qeverisë janë qesharake, duhet ndërhyrë në...

15 Mars, 2022




Sot vendoset nëse Rusia do përjashtohet nga Këshilli i Europës, Tabaku nga Strasburgu: PD do mbështesë rezolutën

15 Mars, 2022



Rritja e çmimeve/ Greqia merr masa, parlamenti pritët të miratojë paketën sociale prej 2 miliardë eurosh

15 Mars, 2022



"Kontratat për import-eksportin e miellit dhe misrit do vijojnë", Krifca në Beograd: Rikonfirmojmë marrëveshjen e "Open Balkan" për tregtinë e lirë të mallrave

15 Mars, 2022